



KUADRI I POLITIKAVE TË ZHVENDOSJES

Për

PROJEKTIN E LEHTËSIMIT TË TREGËTISË DHE TRANSPORTIT

NË SHQIPËRI

| tetor | 2018

Përmbajtja

1	HYRJE	8
1.1	PERSHKRIMI I PROJEKTIT	9
1.2	AKTIVITETET E PROJEKTIT QE REZULTOJNE NE SHPRONESIME DHE HUMBJE AKTIVESH, DHE NDIKIMI I TYRE I PRITSHEM	10
1.3	ARSYET E HARTIMIT TE KUADRI TE POLITIKAVE TE ZHVENDOSJES	10
1.4	PARIMET THEMELORE QE DREJTOJNE PROCESIN E ZHVENDOSJES	11
1.5	OBJEKTIVAT E KPZ-SË	12
2.	KUADRI LIGJOR	14
2.1	KUADRI LIGJOR KOMBETAR	14
2.2	POLITIKAT E BANKËS BOTËRORE PËR RIVENDOSJEN E PAVULLNETSHME (OP/BP 4.12)	15
3.1	ANALIZA E HENDEKUT MES LEGJISLACIONIT KOMBETAR DHE OP 4.12 te BB ..	16
3.	STRATEGJITË E KOMPENSIMIT PËR ZHVENDOSJE TË ZBATUESHME PËR PROJEKTIN TTF	28
3.1	PARIMET KRYESORE	28
3.2	DATA KUFI E REFERENCES.....	28
3.3	KRITERET E TE DREJTET PER KOMPENSIM DHE MATRCIA E PRONESIVE	28
3.4	MATRICIA E TE DREJTAVE	29
4.	PERGATITJA E INSTRUMENTEVE INDIVIDUALE PER ZHVENDOSJEN	32
4.1	SKANIMI PER ASPEKTET SOCIALE DE HARTIMI I PMZ	32
4.2.	MIRATIMI I PMZ	34
4.3	ZBATIMI I PMZ	34
5.	KONSULTIMET DHE PUBLIKIMET	37
5.1.	KONSULTIMET ME PUBLIKUN	37
5.2.	PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE	37
6.	MEKANIZMI PER ZGJIDHJEN E ANKESAVE.....	37
6.1	MEKANIZMI I ANKIMIMIT TE PROJEKTIT	37
6.2	ADMINISTRIMI I ANKESAVE NGA PROJEKTI	38
7.	MONITORIMI DHE VLERESIMI	40
7.1	MONITORIMI I PROCESIT TE ZHVENDOSJES	40

8. KUADRI INSTITUCIONAL	41
8.1 INSTITUCIONET PERGJEGJESE PER ZBATIMIN E PROJEKTIT	41
8.2 INSTITUCIONET KRYESORE NE PROCESIN E SHPRONESIMIT.....	41
9. KERKESAT PER BUXHETIN DHE FINANCIMIN	42

Figura 1: Hapat ne pergatitjen e PMZ.....	36
---	----

Figura 2: Hapat e ankimimit.....	40
----------------------------------	----

LISTA E AKRONIMEVE

FShZh	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
PSMZ	Plani i Shkurtuar i Veprimit për Zhvendosjen
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
KMMS	Kuadri i i Menaxhimit Mjedisor dhe Social
QSh	Qeveria e Shqipërisë
MTA	Mekanizmi i Trajtimit të Ankesave
IMK	Instituti i Monumenteve të Kulturës
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme
KVA	Komiteti Vendor për Ankesat
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
PMO	Plani i Menaxhimit Operacional
OP 4.12	Politika Operacionale 4.12
PAP	Personat e Prekur nga Projekti
NjKP	Njësia e Koordinimit të Projektit
PMZ	Plani i Masave për Zhvendosjen
KPZ	Kuadri i Politikave të Zhvendosjes
VS	Vlerësimi Social
BB	Banka Botërore

LISTA E PËRKUFIZIMEVE/GLOSAR

KOMPENSIMI. Pagesa në mjete monetare ose në natyrë për aktivin/aktivet dhe/ose burimin/burimet e marra ose të prekura nga një projekt. Kompensimi paguhet në të gjitha rastet para shpronësimit të tokës dhe aktiveve në pronësi, edhe kur kjo nuk është e mundur për shkak të mungesës së pronarëve. Në rast të mungesës së pronarëve, paratë do të depozitohen në një llogari ruajtjeje, ose në një llogari tjetër të ngjashme.

DATA KUFI. Data e përfundimit të anketës social-ekonomike që përcakton numrin e personave të prekur dhe masën në të cilën preken pronat dhe aktivet e tjera. Personat që futen në zonën e projektit pas datës së përcaktuar kufi nuk kanë të drejtë kompensimi, ose të drejtë për asnjë formë tjetër asistencë për rivendosje. Në mënyrë të ngjashme, aktivet fikse (siç janë ndërtesat, të mbjellat, pemët frutore dhe jofrutore) të krijuara pas kësaj date nuk do të jenë objekt kompensimi.

HUMBJA EKONOMIKE. Humbja e tokës, aktiveve ose mundësive për t'i shfrytëzuar ato, përfshi dhe ato që cojnë në humbje të burimeve të ardhurave apo mjeteve të jetesës.

SHPRONËSIMI. E drejta e qeverisë për të marrë menjëherë pronësinë apo për të kufizuar pronësinë duke e kompensuar me koston e zëvendësimit të kësaj pronësie.

KOMISIONI AD-HOC I SHPRONËSIMIT. Komisioni i ngritur nga Ministria e Linjës, në këtë projekt Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, për të zbatuar një procedurë të caktuar shpronësimi për token që do të merret apo për zhvendosjet, nëse ka, për të zbatuar cilindo nga komponentet e Projektit TTF.

MEKANIZMI I ZGJIDHJES DHE ADRESIMIT TË ANKESAVE. Mekanizmat dhe procedurat specifike të projektit të krijuara paralelisht me panelet zyrtare të ankimimit, që lejojnë personat e prekur të dorëzojnë një ankimim apo kërkesë, të lidhur direkt ose indirekt me ndikimet që sjell Projekti, pa pasur asnjë kosto për këtë ankimim dhe me të drejtën për të marrë një zgjidhje krenarë dhe në kohën e caktuar për ankimimin apo kërkesën.

ZHVENDOSJA E PAVULLNETSHME. Zhvendosja është e pavullnetshme kur toka apo aktivet e tjera jo-tokë merren me autoritetin e shtetit. Këto veprime mund të jenë marrë pa vullnetin e lire dhe pa informuar me parë një person të caktuar, i cili nuk ka mundësinë e zgjedhjeve alternative.

ZEVENDËSIMI I MJETEVE TË JETESËS. Masat që synojnë t'u vijnë në ndihmë personave të afektuar në pronë dhe/ose ekonomikisht për të rimarrë ose përmirësuar mjetet dhe standardet e jetesës, në terma realë, në nivelet para humbjes së tyre, ose në nivelet përpara fillimit të zbatimit të projektit, sipas asaj në të cilën i prekuri përfiton më shumë.. Ndihma duhet të vazhdojë edhe pas zhvendosjes, për një periudhë tranzitore, bazuar në një

vlerësim të arsyeshëm të kohës që mund të nevojitet për të rikthyer mjetet dhe standardet e jetesës.

PAGESA PËR ZHVENDOSJEN. Pagesa për zhvendosjen është një kompensim në para për shpenzimet që lidhen drejtpërsëdrejti me lëvizjen/zhvendosjen e familjeve të prekura.

PAP-ja. Personi i prekur nga projekti është çdo person i cili, si rezultat i zbatimit të projektit në fjalë, humbet të drejtën për të zotëruar, përdorur ose përfituar nga aktivet (ndertesa, toka për banim, bujqësi ose kullote), të mbjellate përvitshme ose shumëvjeçare dhe pemët, ose çdo pasuri tjetër paluajtshme dhe të luajtshme, tërësisht ose pjesërisht, përgjithmonë ose përkohësisht.

ZHVENDOSJA FIZIKE. Humbja e strehës ose pasurisë shkaktuar nga shpronësimi i tokës në lidhje me projektin, e cila kërkon zhvendosjen fizike të personave të prekur nga projekti nga vendi ose vendbanimi ku gjendeshin para projektit, vendi i punës ose vendet e biznesit.

PROMOVUESI I PROJEKTIT-NJESIA E ZBATIMIT TE PROJEKTIT (NJZP).

Promovuesi i Projektit dhe NJZP janë entitet, me emrin Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe që luajnë funksion të dyfishtë. NJZP është një njesi e vecante, e ngritur në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe që ka në përberje të saj një ekspert për çështjet mjedisore dhe sociale dhe që njeh politikën dhe procedurat e Bankës Botërore dhe legjislativin përkatës shqiptar, një specialist prokurimesh, një specialist të menaxhimit financiar, ekspertë të tregëtisë dhe transportit dhe një drejtues të Njesisë. Kjo njesi ka përgjegjësinë për zbatimin e projektit, respektimin e Kuadrit të Politikave të Zhvendosjes, dhe me pas të zbatimit të Planit të Masave të Zhvendosjes duke siguruar burimet financiare në buxhet, si dhe disbursimin, shpenzimin dhe auditimin e tyre financiar. Përkufizimi NJZP do të përdoret në këtë dokument për të emëruar entitetin përgjegjës për zbatimin e këtij Kuadri Politikash të Zhvendosjes dhe çdo Plan Masash të Zhvendosjes në periudhat në vijim.

KOSTOJA E ZËVENDËSIMIT. Për tokën bujqësore, kostoja e zëvendësimit është vlera e tregut përpara projektit, ose përpara zhvendosjes, duke përdorur atë që është më e lartë, e tokave me potencial të barabartë prodhues ose në afërsi të tokës së prekur, plus kostot e nevojshme për kadastrimin apo rregjistrimin e saj, si dhe për transferimin e kësaj aseti. Për tokën në zonat urbane, është vlera e tregut të tokës përpara zhvendosjes e krahasuar me toka me madhësi dhe përdorim të barabartë, me objekte dhe shërbime infrastrukturore të ngjashme ose të përmirësuara që ndodhen në afërsi të tokës së prekur përpara zhvendosjes, plus kostoja e çdo tarife regjistrimi dhe transferimi. Për shtëpitë dhe strukturat e tjera, kostoja e zëvendësimit është kostoja e tregut e materialeve të nevojshme për të ndërtuar po atë strukturë me një sipërfaqe dhe cilësi të ngjashme ose më të mirë se ato të strukturës së prekur, ose për të riparuar një strukturë pjesërisht të prekur, plus kostoja e transportit të materialeve të ndërtimit në vendin e ndërtimit, plus kostoja e punës dhe kontraktorit të

punimeve, plus kostoja e çdo takse regjistrimi dhe transferimi. Në përcaktimin e kostos së zëvendësimit, nuk merret parasysh amortizimi i aktivitetit dhe vlera e materialeve të mbetura dhe të riperdorshme, dhe po ashtu, vlera e përfitimeve që mund të vijnë nga projekti që dikush mund të kërkojë t'i zbrese në vlerësimin e një aktiviteti të prekur. Ajo përfshin gjithashtu edhe kostot e nivelimit, ose të përgatitjeve të tjera për ndërtimin e ri, apo përdorimin e mepasem të aktivitetit. Kostot llogariten mbështetur në kohën e zëvendësimit të aktiveve, dhe nëse jo, gjatë llogaritjes së kostove merret parasysh edhe inflacioni.

PLANI I SHKURTUAR I VEPRIMIT TË ZHVENDOSJES (PShVZ). Dokumenti që specifikon procedurat që duhen ndjekur dhe veprimet që duhen ndërmarrë për të parandaluar efektet e padëshirueshme, për të kompensuar humbjet dhe për të siguruar përfitime zhvillimore për personat dhe komunitetet e prekura nga një projekt investimi në rastet kur projekti prek më pak se 200 persona dhe kur ndikimet e zhvendosjes janë të vogla.

NDIKIME TË VOGLA TË ZHVENDOSJES. Në mënyrë që zhvendosja të konsiderohet se ka ndikime të vogla, duhet të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: (a) ndikimet konsiderohen "të vogla" nëse njerëzit e prekur nuk zhvendosen fizikisht dhe kur ata humbasin më pak se 10 për qind të produkteve të tyre prodhuese; b) pjesa tjetër e tokës mbetet ekonomikisht e përdorshme.

KUADRI I POLITIKAVE TË ZHVENDOSJES (KPZ). KPZ-ja është një instrument i projektit që synon të përcaktojë principet dhe parimet e zhvendosjes, rregullimet institucionale dhe kriteret që do të aplikohen për nënprojektet e ndryshme gjatë zbatimit të projektit. Ai përmban përkufizime të qarta të kushteve në të cilat do të planifikohet dhe zbatohet zhvendosja (për një projekt specifik, një program sektorial, ose brenda një entiteti politik, si një shtet apo një ndarje tjetër administrative rajonale), si do të planifikohet dhe zbatohet ajo. Ai përkufizon aspekte të tilla si drejta mbi pronën, parimet e kompensimit, proceset e ankesave dhe procedura të tjera ligjore. Kuadri i Politikave të Zhvendosjes është i detyrueshem për projekte me disa nënprojekte ose me disa komponentë që nuk mund të identifikohen para vlerësimit të projektit.

PALET E INTERESUARA. Çdo individ dhe të gjithë individët, grupet, organizatat dhe institucionet e interesuara dhe potencialisht të prekura nga një projekt, ose që kanë munesinë të ushtrojnë ndikimin e tyre mbi atë projekt.

1 HYRJE

Banka Botërore po shqyrton mundësinë e hyrjes në Projektin e Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit, duke mbështetur kështu përpjekjet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të qënë e harmonizuar me Agjendën e Konektivitetit dhe përpjekjet institucionale për të nxitur integrimin rajonal, duke pranuar se lehtësimi i tregtisë dhe transportit janë elementë kyç për thellimin e integritetit ekonomik në rajon dhe në BE. Projekti është pjesë e një Qasjeje Programore me Shumë Faza, i cili në fazën e parë mbulon Serbinë, Shqipërinë dhe Republikën e Maqedonisë, duke mbështetur një kombinim të investimeve, asistencës teknike dhe reformave rregullatore dhe institucionale.

Një sërë dokumentesh dhe studimesh, të cilat shqyrtojnë faktorët kritikë që pengojnë rritjen ekonomike i kanë identifikuar mungesat në infrastrukturë si dhe kostot e larta të transportit që së bashku me agjencitë rregullatore dhe kontrolluese janë shkak për vonesat që ndikojnë në transport dhe tregti.

Projekti do të ketë një KUADER specifik të MANAXHIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (KMMS) për të shërbyer si një udhëzues për skanimin fillestar të aktiviteteve të propozuara të projektit për çdo ndikim negativ mjedisor dhe social, dhe që do të kërkojë vëmendje përpara zbatimit të projektit. Projekti nuk ka të ngjarë të kërkojë shpronesime masive të tokës për zbatimin e komponentëve të propozuar. Nga të gjithë komponentët, vetëm **Komponenti 1, Lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të mallrave**, duke u përqendruar, por pa u kufizuar vetëm te përmirësimet në kalimet në pikat kufitare në korridoret tregtare të përzgjedhura, është i vetmi komponent që mund të kërkojë shpronesim. Ka shumë pak të ngjarë që të kërkojë zhvendosje fizike për shkak të këtij projekti.

Pavarësisht kësaj, KMMS-ja e miratuar për Projektin ka parashikuar një procedurë për shqyrtimin aspekteve sociale për të identifikuar ndikimet e padëshiruara përmes një formulari analize. Nëse rezultatet e analizës flasin për ndikime negative sociale që kërkojnë zbatimin e OP. 4.12 të Bankës Botërore, Promovuesi i Projektit do të zbatojë masat parandaluese dhe lehtësuese, siç përcaktohet në këtë KPZ KPZ-ja ofron udhëzime për përgatitjen e instrumenteve specifike të zhvendosjes në çdo vend specifik të Projektit, si kusht paraprak për fillimin e punimeve inxhinierike për çdo nënprojekt të tillë që kërkon shpronesim, zhvendosjen e pavullnetshme dhe humbjen e mjeteve jetesës si rezultat i drejtpërdrejtë ose i krijuar nga Projekti. Mbështetur në informacionet dhe planet në fazën e para vlerësimit, ndoshta do të duhe të kete shpronesim të tokës për përmirësimin e Pikës Kufitare të Qafë Thanës në pikën e kalimit kufitar midis Shqipërisë dhe IRJ-së së Maqedonisë. Ky komponent do të përfshijë përmirësime dhe riparimin i objekteve dhe akseseve të përzgjedhura, si dhe sigurimin i pajisjeve për të përshpejtuar inspektimin dhe lëvizjen e mallrave. Këto përfshijnë hapësira të reja parkimi, përmirësimin e ndërtesave administrative, ndërtimin e rrugëve me një drejtim ekskluziv për transportin e mallrave dhe përmirësimin e qarkullimit të trafikut përmes terminalit doganor. Nuk parashikohet ndërtimi i rrugëve të reja.

1.1 PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti ka kater komponente qe lidhen me lehtesimin e tregetise dhe transportit. Hollesite jepen me poshte:

Komponenti 1: Lehtsimi i levizjes se mallrave ne pikat kufitare

Nenkomponenti 1a. Projektimi dhe Instalimi i “Procedures Kombetare NJE SPORTEL” (PKS), qe do te behet ne dy faza – faza pergatitore dhe e disnjimit dhe faza e instalimit -- qe do te kerkojne pergjithesisht 4-5 vjet qe te perfundojne (dhe vetem njera faze do te jete ne projektin e propozuar). Faza e instalimit perfshin instalimin e sistemeve te tekonoligjise se informacionit qe do te ndihmojne ne rritjen dhe permiresimin e transparences si dhe eliminim e situatave te paparashikuara per tregetimin e mallrave.

Nenkomponenti 1b. Permiresime ne Pikat e Kalimit Kufitar ne Korridore Tregetare te perzgjedhura

Proketi do te permiresoje kapacitetin fizik dhe kushtet e funksionimit ne disa pika kyce te kalimit kufitar. Ky komponent perfshin n epermiresimin dhe riparimin e objekteve te caktuara dhe akssin ne keto korridore tregetare, si dhe financimin e pajisjeve per te shpejtuar inspektimin dhe qarkullimin e mallrave. Gjithashtu perfshin hapesira te reja parkimi, rkonstruksionin e ndertesave administrative, ndertimin e hyrje-daljeve nje-kalimshe ekskluzivisht per mallrat dhe permiresimin e qarkullimit permes terminalit doganor. Nuk parashikohet ndertimi i rrugeve te reja

Komponenti 2 Rritja e efienes dhe parashikueshmerise ne transport

Ky komponentet fokusohet ne (a) adoptmin e sistemeve inteligjente te transportit (SIT) dhe monitorimin e performances se korridoreve te te transportit dhe (b) ngirtjen e nje Sistemi te Monitorimit te Trafikut te Anijeve (SMTA).

Nenkomponenti 2a Sistemet Inteligjente te Transportit (SIT). Projekti do te parashikojë perdorimin e SIT ne korridore te caktura rrugore dhe do te integroje elementet ekzistues te SIT ne nje platforme te integruar. Pajisjet SIT qe do te financohen ne fazen e pare jane si me poshte: (a) nje sistem per mbledhjen e te dhenave te trafikut ne vende te pozicionuara ne trupin e rruges (b) Peshim i Mjeteve ne Levizje (PML), (c) Pajisje per kontrollin e lartesis se mjeteve ne rruge (d) nje sistem per mbledhjen e te dhenave per kushtet e motit pergjate akseve rrugore (stacione meterologjike)

Nenkomponenti 2b. Sistemi i Monitorimit te Trafikut te Anijeve (SMTA). Per Shqiperine ky eshte nje sistem e domosdoshem per monitorimin e anijeve ne det. SMTA eshte nje zgjatim i Sherbimit te Trafikut te Anijeve (STA) ne formen e nje Survejimi te Integruar Detar qe perfshin siteme te tjera telematike per te lejuar sherbimet e vendeve te tjera aleate dhe agjenci te tjera te interesuara per ndarjen e te dhenave STA apo per te perdorur nensisteme te caktuara per te rritur efektivitetin e operacioneve detare dhe portuale.

Komponenti 3 Rritja e aksesit ne tregje per Sherbimet Tregetare dhe Investimet

Ky komponent do te mbeshtese implementimin e angazhimeve te marra per te permiresuar aksesin e tregut ne sherbime te caktuara dhe per te rritur investimet rajonale permes asistences teknike dhe mbeshtetjes qe do te jepet per zbatimin e reformave institucionale dhe rregullatore

Komponenti 4 Mbeshtetje per manaxhiin e projektit dhe koordinimin e politikave

Ky komponent do te mbeshtese njesine e zbatimit te projektit duke i dhene mbeshtetje teknike shtese, perfshi dhe koordinimin e politikave, monitorimin dhe vleresimin e projektit.

1.2 AKTIVITETET E PROJEKTIT QE REZULTOJNE NE SHPRONESIME DHE HUMBJE AKTIVESH, DHE NDIKIMI I TYRE I PRITSHEM

Vetëm në Nëkomponentin 1b mund të pritet të ketë shpronesime që mund të kerkohen për të rritur kapacitetin fizik të pikave kufitare. Ndikimet priten te jene te kufizuara veten ne shpronesime toke dhe ka shume pak te ngjare te kerkojne zhvendosje te ndertesave te banimit, apo te bizneseve. Ky komponent do te perfshije permiresim te ndertesave te caktuara dhe te aksiseti ne korridoret rrugore, si dhe finncimin e pajisjeve per te persheptuar qarkullimin e mallrave. Kjo e perkthyer, por jo e kufizuar, ne zona te reja parkimi, rikonstruksion i ndertesave administrative, ndertimin e korsive nje-kalimshe per mallrat dhe permiresimin e qarkullimit permes terminalit doganor. Nuk parashikohet te ndertohen rruge te reja.

1.3 ARSYET E HARTIMIT TE KUADRIT TE POLITIKAVE TE ZHVENDOSJES

Per shkak te natyres dhe dizenjimit te projektit dhe komponenteve e nenkomponenteve specifike te tij, shkalla, qellimi dhe zona e ndikimit te nenprojekteve nuk mund te percaktohet saktesisht gjate fazes se pergatitjes, dhe kjo eshte arsyeja qe nuk mund te pergatitet qe tani nje Plan Masash te Zhvendosjes (PMZ). Ne momentin qe hapësira e kerkuar eshte percaktuar dhe projektet teknike jane hartuar, do te hartohet nje PMZ e vecante ne perputhje me procedurat e percaktuara ne kete KPZ. KPZ eshte pergatitur per te udhezuar procesin potencial te shpronesimeve dhe the zhvendosjeve per permiesimet e parashikuar ne permiresimin e pikave te kalimit kufitar ne perputhje me kerkesat e Bankes Boterore (BB) dhe Politikave Operacionale (OP) 4.12 te saj, si dhe kerkesat e legjislacionit kombetar.

OP 4.12 e BB udhezoi qe KPZ duhet te pergatitet gjate vlersimit te projektit, nese mendohet qe projekti do te kete zhvendosje jo vullnetare. Objektivi i ketij dokumenti eshte te jape parimet udheheqese qe zbatimi i projektit TTF ka si qellim te siguroje marrjen e masave te duhura, efektive dhe ne kohen e duhur, te specifikuar sipas prioriteteve, ne menyre q te menjanoje, minimizojte dhe kompensoje te gjithe ndikimet e padeshiruara gjate

zhvendosjes. KPZ pergatitet ne perputhje me sistemin ligjor, ligjet dhe procedurat e Republikës së Shqipërisë, ne konformitet me politikat e BB për zhvendosjet dhe praktikatat me të mira ndërkombëtare. KPZ gjithashtu na siguron një platformë detyruese për të hartuar instrumentet e zhvendosjes për një zonë të caktuar: PMZ, PSMZ, që hartohen në gjatë zbatimit të projektit dhe që janë manuali për realizimin e zhvendosjeve.

1.4 PARIMET THEMELORE QË DREJTOJNE PROCESIN E ZHVENDOSJES

Gjatë zbatimit të Projektit, nevoja për shpronësime tokë dhe zhvendosje jo vullnetare mund të materializohet si rezultat i planifikimit të punimeve ndërtimore për një numër të caktuar komponentesh të këtij Projekti.

Ky dokument ofron parime gjithëpërfshirëse dhe detyruese për t'u zbatuar në të gjitha rastet e zhvendosjes fizike, zhvendosjes ekonomike dhe të gjitha ndikimet e tjera negative të shkaktuara nga zbatimi i Projektit pavarësisht se për cilën fazë bëhet fjalë. Këto parime do të udhëheqin të gjitha veprimet e Promovuesit të Projektit dhe përfaqësuesve të tij, Njësisë së Zbatimit të Projektit e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, përfaqësuesve të filialeve të tyre nëse ka, kontraktorëve, dhe të gjitha institucioneve të tjera shtetërore dhe vendore të përfshira në zbatimin e Projektit.

Parimet themelore që udhëheqin procesin e rivendosjes nën këtë Projekt janë:

- Nëse është e mundur, duhet të shmangen të gjitha zhvendosjet duke studjuar të gjitha alternativat e mundshme gjatë hartimit të projekteve teknike dhe përzgjedhjes së alternativave.
- Nëse shmangia nuk është e mundur, efektet e dëmshme e të padëshirueshme duhet të kufizohen në minimumin e pashmangshëm.
- Kur ndodhin efekte të padëshirueshme e të paevitueshme me ndikime sociale, të gjitha humbjet e pronës duhet të kompensohen në vlerën e kostove të zëvendësimit dhe mjetet e jetesës së PAP duhet të rikthehen në të paktën nivelin para zbatimit të Projektit, ose më mirë se atë.
- PAP-të do të ndihmohen gjatë të gjitha fazave të Projektit në përpjekjet e tyre për kthimin mjeteve dhe standardeve të jetesës në terma realë deri në nivelin para nisjes së investimeve që shkaktojnë këto humbe.
- Të gjitha zhvendosjet duhet të menaxhohen në përputhje me legjislacionin kombëtar, OP 4.12 të BB, me praktikatat me të mira e të pranueshme ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij dokumenti. Kur ka boshllëqe, në bazë të marrëveshjes mes BNB dhe Qeverisë Shqiptare, do të prevalojnë dispozitat e këtij KPZ, ose ato me shtresë më të lartë. Si rregull themelor, nën këtë KPZ, gjatë zbatimit të projektit, gjithnjë mbizotërojnë ato politika që janë më të dobishme dhe më përfituese për PAP-in.
- Njesia e Zbatimit të Projektit do të përfshihet në të gjitha aktivitetet e zhvendosjes dhe në fazën më të hershme të mundshme në hartimin e projekteve teknike, me

qëllim sigurimin e zbatimit me kosto efektive, efikase dhe në kohë të parimeve dhe objektivave të përcaktuara nga kjo KPZ si dhe promovimin e qasjeve novatore për përmirësimin mjeteve dhe standardeve të jetesës së personave të prekur nga rivendosja e jo e vullnetshme.

- Mbeshtetje e vecante do tu jepet grupeve shoqerore të prekura apo në nevojë, sipas specifikave të tyre, në të gjitha fazat e projektit.
- Projekti do të perdore dhe sigurojë një përfaqësim sensitiv për përfshirjen e grave, si pjesë e familjeve të prekura, në të gjitha konsultimet publike, dhe në diskutimet për masat specifike zbutëse. Të gjithë aktivitetet e PMZ do të synojnë të jenë të përshtatura në aspektin gjinor, me qëllim fuqizimin e rolit të grave dhe për tu dhënë atyre mundësi të barabarta për zbutjen e ndikimeve nga zhvendosjet. Dokumentacioni i pronësive apo i okupimit të një objekti të caktuar, si titujt e pronësive, kontratat e qerash (përfshirë edhe llogaritë bankare të përcaktuara për pagesën e kompensimit) do të lëshohet në emrat e të dy bashkëshortëve, nëse pronat e shpronësuara janë pjesë e pasurisë martesore të të dy bashkëshortëve. Ndihma të tjera për zhvendosjen, si trajnime për aftësimin profesional, aksesin në kreditim dhe mundësitë për punësim, do të ofrohen në mënyrë të barabartë burrave dhe grave, dhe do të përshtaten me nevojat e tyre.
- Në përputhje me këtë KPZ, do të përgatitet dhe botohet Plani i Masave për Zhvendosje (ose Planin e Shkurtuar të Masave për Zhvendosje), si edhe do të organizohen konsultime publike përpara miratimit përfundimtar të tyre për t'i lejuar personat e prekur dhe palët e interesuara të marrin pjesë në zhvillimin, planifikimin dhe zbatimin e programeve të zhvendosjes.
- Si pjesë e përgatitjes së PMZ/PMSZ specifike për një zonë të caktuar, dhe përpara se të fillojnë punimet e ndërtimit që do të rezultojnë në zhvendosje fizike apo humbje ekonomike, duhet të jete ngritur sipas këtij KPZ një Mekanizëm për Zgjidhjen e Ankesave (MZA) ku të kenë akses të gjithë PAP. Gjatë zbatimit të projektit dhe ciklit të zhvendosjes, palët e interesuara do të pajisen me informacion të plotë rreth të drejtave, mundësive dhe procedurave të ankimimit. Gjatë zbatimit të Projektit dhe aktiviteteve të zhvendosjes do të merren parasysh të gjitha ankesat.
- Të gjitha aktivitetet e zhvendosjes do të perceptohen dhe realizohen si projekte të qëndrueshme duke ofruar burime të mjaftueshme për investime, për të bërë të mundur përmbushjen e plotë të parimeve dhe objektivave të zhvendosjes të përcaktuara nga kjo KPZ.

1.5 OBJEKTIVAT E KPZ-SË

Objektivi kryesor i KPZ-së është të përcaktojë parimet, procedurat, masat, strukturat organizative dhe kërkesat për kapacitete gjatë rivendosjes dhe ndikimit që i atribuohet

zbatimit të Projektit. Ai siguron gjithashtu kuadrin për përgatitjen e instrumenteve specifike të rivendosjes për terrenin specifik sipas projektit.

Objektivat specifike janë:

- klasifikimi i zgjidhjeve ligjore kombëtare në të gjitha rastet e rivendosjes së pavullnetshme, rivendosjes dhe humbjes së pasurisë, duke përfshirë procedurat ligjore dhe administrative dhe kompensimin e paguar për humbjen e pasurisë;
- krahasimi i tyre me politikat Bper zhvendosjet dhe me praktikën e mira ndërkombëtare; dhe ofrimi i mënyrës për të kapërcyer hendekun mes tyre, nëse ka;
- Identifikimi i institucioneve kyçe, përveç NJZP, të përfshirë në zbatimin e Projektit, duke përfshirë veçanërisht institucionet shtetërore të autorizuar me ligj për zbatimin e procedurave dhe garancive të procesit të zhvendosjes së pavullnetshme;
- Hartimi i kriterëve të monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar pajtueshmërinë me OP 4.12, praktikën e mira ndërkombëtare, këtë KPZ dhe PMSZ;
- prezantimi i kriterëve të kualifikimit dhe matrices së të drejtave të kompensimit për PAP-et, sipas llojit të aktiveve dhe pasurive të humbura;
- përcaktimi i procesit të identifikimit dhe vlerësimit të pasurive të prekura dhe i vlerës së kompensimit për të zëvendësuar humbjen e pasurisë;
- ofrimi i procedurave që lejojnë kompensim të menjëhershëm dhe efektiv me kosto të plotë zëvendësimi për humbjen e pasurisë ose aksesit në pasuri;
- përshkrimi i masave zbutëse duke përfshirë procedurat për minimizimin e ndikimeve mbi PAP-të gjatë zbatimit të Projektit, duke përfshirë masat specifike zbutëse të parashikuara për grupet e pambrojtura dhe gratë;
- përcaktimi i të drejtave për ankimim dhe ankesa, për procesin, organet dhe procedurat në dispozicion të PAP-ve gjatë tërë kohës së zbatimit të Projektit, duke përfshirë raportimin e opinioneve se si ato ankesa janë zgjidhur;
- përshkrimi dhe ofrimi i udhëzimeve për përgatitjen e PMZ ose PMSZ dhe procedurën e miratimit, përmbajtjen dhe procesin e zbatimit të tyre;
- specifikimi i kërkesave për informimin e publikut, vendjen në dispozicion të dokumenteve, përfshirjen e publikut dhe komunitetit lokal në të gjitha fazat e përgatitjes së Projektit, përfshi KPZ dhe PMZ;
- sidomos duke përfshirë konsultimin publik në komunitetin e PAP-ve gjatë procesit të zhvendosjes jo vullnetare dhe zbatimit të Projektit që mund të çojë në humbjen e aseteve;
- krijimi i një kuadri të ndjeshëm gjinor për zhvendosjen me qëllim diferencimin e ndikimeve, përshkak se pesha e këtyre ndikimeve dhe vështirësitë në vijim nuk janë njësoj si për burrat ashtu dhe për gratë;
- specifikimi i aktiviteteve të monitorimit të brendshëm gjatë të gjitha fazave të zbatimit të Projektit, veçanërisht lidhur me çështjet e zhvendosjes, zbatimin korrekt

- te proceseve ligjore dhe proceseve të përcaktuara në këtë KPZ, përfshirë vlersimin e procsit të zhvendosjes si dhe monitorimin nga publiku dhe vlersimin prej tij;
- Ngritja e Mekanizimit të Zgjidhjes së Ankesave (MZA) për të siguruar njerezve që besojnë se janë të ndikuar negativisht nga projekti një mënyrë për të shprehur shqetësimet dhe nevojat e tyre;

2. KUADRI LIGJOR

2.1 KUADRI LIGJOR KOMBETAR

Dokumentet e mëposhtëme përfshirjnë bazën ligjore, të politikave dhe rregullatore për këtë Kuadër të Politikave të Rivendosjes.

- Kushtetuta e Shqipërisë¹
- Ligji Nr. 10 428, i miratuar në vitin 2011 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, pra Ligji mbi epërsinë e narrëveshjeve Ndërkombëtare²
- Ligji nr. 8561 "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interesa publike" i miratuar në vitin 1999 dhe i ndryshuar në 20/2016)
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 138, datë 23. 3. 2013, që parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e pronave të prekur nga shpronësimi, dhe

Informacion i përgjithshëm mbi Ligjin e Republikës së Shqipërisë “Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interesa publike” i miratuar në vitin 1999 (i ndryshuar në vitin 2016)

Ligji për shpronësimin dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interesa publike (miratuar në vitin 1999, dhe ndryshuar në 2016) udhëzon procesin e blerjes së tokës dhe shërben si një kornizë e përgjithshme për shpronësimet në Republikën e Shqipërisë.

Ligji nuk e përdor termin "zhvendosje jo e vullnetshme", term i cili përdoret në dokumentet përkatëse të politikave të Bankës Botërore, por në vend të tij përdor termin shpronësim.

Ky ligj u mundëson institucioneve qeveritare dhe në një farë mase personit juridik privat të fitojë pronë private për projekte që konsiderohen si me interes kombëtar dhe/ose lokal, ndërkohë që mbron interesat e të gjithë personave të prekur nga projekti me titull ligjor pronësie, pasuritë e të cilave janë të shpronësohen. Ligji përmban gjithashtu edhe parimin e kompensimit të drejtë.

Tiparet më të rëndësishme të ligjit për shpronësim janë:

¹ Kushtetuta e Shqipërisë - http://www.pp.gov.al/web/kushtetuta_perditesuar_822.pdf

- Ligji përmban një listë të plotë të asaj që konsiderohet si interes publik (neni 8/ç i ligjit "Për shpronësimet ...").
- Subjekti përfitues në procesin e shpronësimit do të jetë bashkia përkatëse e secilit qytet (neni 9 i ligjit "Për shpronësimin ...").
- Bashkia duhet të paraqesë kërkesën me një listë të dokumenteve të nevojshme në Ministrinë e linjës, përkatësisht në Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe në Institutin e Monumenteve të Kulturës, në këtë rast (me strukturën e qeverisë aktuale).
- Ministria e linjës boton kërkesën për shpronësim, grumbullon ankesat e pronarëve të prekur dhe përgatit draftin e aktit nënligjor për Këshillin e Ministrave.
- Ministria e linjës krijon një komision të posaçëm për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e procedurës së shpronësimit.
- Procedura konsiderohet e plotë kur pronarët, përmes një deklarate, miratojnë transaksionin e pronës në favor të Qeverisë.
- Vendimi i shpronësimit (për pronarët që nuk bien dakord me shpronësimin) miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe hyn në fuqi menjëherë, dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
- Pronarët e prekur kanë akses në procedurat gjyqësore nëse nuk arrihet marrëveshje miqësore për kompensimin. Megjithatë, nëse nuk merret pëlqimi, vendimi i Këshillit të Ministrave do të jetë përfundimtar dhe detyrues.
- Zhvlerësimi i pronës. Kompensimi është i detyrueshëm në rastet kur, edhe pse nuk merret tokë, procesi çon në prekjën e pronave ose të aksesit në prona, ose të jetesës (kur toka zhvlerësohet dhe jetesa përkeqësohet si rezultat i projektit).
- Për pjesë të paarrtshme të tokës (toka jetime) PAP-i ka të drejtë të marrë:
- Zënia e përkohshme e tokës. Gjatë zbatimit të një projekti të caktuar, toka mund të kërkohej në baza të përkohshme. Për një tokë të tillë do të paguhet qiraja dhe toka do të rivendoset në kushtet para ndërhyrjeve të projektit dhe do t'i kthehet pronarit. Një kërkesë e tillë i drejtohet Ministrisë së Zhvillimit Urban, ku përshkruhet prona e kërkuar, justifikimi, afati i marrjes në përdorim dhe kompensimi i ofruar. Kundër një vendimi të tillë, pronari ka të drejtë të kërkojë zgjidhje jridike para gjykatës.

2.2 POLITIKAT E BANKËS BOTËRORE PËR RIVENDOSJEN E PAVULLNETSHME (OP/BP 4.12)

Të gjitha projektet e BB-së të cilat përfshijnë zhvendosjen e pavullnetshme janë objekt i OP 4.12. Kjo politikë përshkruan procedurat dhe instrumentet për eliminimin e aspekteve negative ekonomike, sociale dhe mjedisore të cilat mund të sjellin në skenë këto Politike Operacionale, dhe jo vetëm për rastet e zhvendosjes fizike, por edhe për çdo humbje toke që çon në zhvendosje, ose humbje të strehimit, humbje të aseteve ose të aksesit në asete dhe humbje të burimeve të ardhurave dhe mjeteve të jetesës.

Objektivat e përgjithshme të OP 4.12 janë si më poshtë:

- (a) Zhvendosja jo e vullnetshme duhet të shmanget aty ku është e mundur, ose të minimizohet, përmes shfrytëzimit të të alternative të mundshme të dizenjimit të projektit.
- (b) Aty ku nuk është e mundur, aktivitetet e zhvendosjes duhet të konceptohen dhe të zbatohen si programe të zhvillimit të qëndrueshëm, duke siguruar burime të mjaftueshme investimi për t'u mundësuar personave të zhvendosur nga projekti që të jene pjese e përfitimeve që ky projekt do të sjellë.. Personat e prekur duhet të konsultohen në mënyrë domethënëse e të thelluar dhe tu jepet mundësia të marrin pjesë në planifikimin dhe zbatimin e programeve të zhvendosjes.
- (c) Personat e zhvendosur duhet të ndihmohen për të përmirësuar jetesën e mëparshme dhe standardet e mëparshme të jetesës, ose të paktën t'i rivendosin ato, në terma realë, në nivelet para zhvendosjes ose në nivele që kishin para fillimit të zbatimit të projektit, cilido prej këtyre niveleve qoftë më i larti.

OP 4.12 bën dallimin midis tri kategorive të mëposhtme të personave për të drejtën për kompensim dhe ndihmë:

- (a) Personat me të drejta formale mbi tokën (duke përfshirë të drejtat zakonore dhe të drejtave tradicionale të njohura sipas ligjeve të vendit).
- (b) Personat të cilët nuk kanë të drejta formale mbi tokën në kohën e fillimit të censusit, por pretendojnë të drejtën mbi këtë tokë dhe asetet, kur këto pretendime mund të njihen sipas ligjeve të vendit, ose të pranohen nëpërmjet një procesi të identifikuar në planet e veçanta të zhvendosjes.
- (c) Personat pa të drejtë ligjore të njohur, apo që nuk u njihet as pretendimi për të kërkuar të drejtën e pronësive për tokën që ata zënë.

3.1 ANALIZA E HENDEKUT MES LEGJISLACIONIT KOMBETAR DHE OP 4.12 te BB

Objektivat e OP. 4.12 janë të qarta në qëllimin e tyre për të shmangur rivendosjen e pavullnetshme të shkaktuara nga shpronësimet, kudo që është e mundur dhe, nëse nuk është e mundur, për të aplikuar parimet e kompensimit për ndikimet e këtij procesi ndaj të gjithë PAP-të dhe për të rikthyer standardin e tyre të jetesës të paktën në nivelin para realizimit të projektit. Në përgjithësi, kuadri institucional për shpronësimin në Shqipëri nuk është plotësisht në përputhje me OP. 4.12, dhe dallimet më të dukshme kanë të bëjnë me kërkesat për të kompensuar koston e zëvendësimit të tokës në krahasim me kërkesat kombëtare për kompensimin e tokës me vlerën e tregut, pa paguar taksat dhe tarifatat si pjesë e paketës së kompensimit. Përveç kësaj, ligji kombëtar nuk i njeh përdoruesit, zaptusit dhe vendbanimet e paligjshme. Ligji kombëtar nuk kërkon një mekanizëm specifik të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave, një vlerësim të ndikimit social, të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe tipit të personave në nevojë.

Tabela më poshtë ofron një pasqyrë të mangësive specifike midis ligjit kombëtar të shpronësimit në krahasim me OP 4.12 dhe rekomandime për korrigjimin dhe/ose zbutjen e këtyre mangësive në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e OP 4.12.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Censusi dhe anketa social-ekonomike dhe Plani i Masave te Zhvendosjes (PMZ).	Nuk ka kërkesa të qarta lidhur me studimet socio-ekonomike ose zhvillimin e çfarëdo lloji instrumenti rivensosjeje, pavarësisht shkallës së ndikimit. Sidoqoftë, ligji kërkon një inventar të personave dhe pronave të prekura, pa analizën dhe treguesit social-ekonomik.	Realizimi i censusit dhe anketës social-ekonomike për PMSZ. Studimi duhet të përfshijë informacion mbi (i) banorët aktualë në zonën e prekur, (ii) karakteristikat e familjeve të zhvendosura dhe të standardeve të tyre të jetesës dhe mjetet e jetesës, (iii) shkallën e humbjeve të pritshme dhe shtrirjen e zhvendosjes, dhe (iv) informacion mbi grupet ose personat e cenueshëm.	Censusi dhe anketa social-ekonomike e kryer sipas kërkesës së BB-së, plus kërkesave sipas legjislacionit kombëtar
Data kufi reference e përcaktuar për kualifikim	Data reference e përcaktuar për vlerësimin e pronave të prekura nuk është specifikuar drejtpërsëdrejti nga ligji i shpronësimit, megjithatë investimet e bëra në prona pas datës së vlerësimit përfundimtar të kryer nga Komiteti i Shpronësimit nuk do të merren parasysh për kompensim.	Zakonisht, data e references është data e fillimit të censusit. Data e përcaktuar mund të jetë gjithashtu edhe data kur skicohet zona e projektit, para censusit, me kusht që të ketë shpërndarje efektive të informacionit për publikun në lidhje me zonën e përcaktuar dhe shpërndarje sistematike dhe të vazhdueshme pas skicimit për të parandaluar flukse të tjera të popullsisë. Personat që mbërrijnë në zonë pas datës së caktuar	Data e prerjes për qëllime të kualifikimit do të jetë data e fillimit të censusit. Njoftimi për Moratoriumin, përmes të cilit informohet publiku i gjerë se personat që shkelin në zonë pas datës së caktuar nuk kanë të drejtë për kompensim ose për asnjë formë tjetër ndihme për rivendosje, duhet të shpallet

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
		nuk kanë të drejtë për kompensim ose për asnjë formë tjetër asistence për rivendsoje.	publikisht në mënyrë të përshtatshme.
Kualifikimi për kompensim (informal)	Ligji njih vetëm pronësinë formale dhe personat pa të drejtë formale kanë të drejtë të pretendojnë një tokë ose pronë të tillë me kusht që këto pretendime të njihen sipas ligjeve të vendit, ose të pranohen. Pronarët joformalë bien krejtësisht jashtë procedurës së shpronësimit dhe, për pasojë, nuk regjistrohen përmes censusit formal, nuk konsultohen për blerjen e tokës dhe nuk kanë të drejtë për kompensim dhe/ose ndihmë. Ligji shqiptar për shpronësimet Nr. 8561 (i ndryshuar 20/2016) nuk përcakton në mënyrë të shprehur kushtet e kualifikimit për kompensim, megjithatë ai ndjek parimin themelor ligjor se si mund të fitohen pronat dhe se si mund të përcaktohet pronësia	Sipas OP 4.12 të bankës Botërore ka 3 kategori personash sa i përket kualifikimit për kompensim: a) Personat me të drejta formale mbi token; b) Personat të cilët nuk kanë të drejta formale mbi tokën në kohën e fillimit të censusit, por kanë pretendime mbi këto toka, ose prona, me kusht që këto pretendime të njihen nga legjislacioni kombëtar; c) Personat të cilët nuk kanë të drejta ose pretendime ligjore të njohura mbi tokën që ato kanë zënë.	Data kur do të kryhet censusi duhet të dakordohet me klientin dhe të përcaktohet në planin e rivendsojes/rikuperimit të jetesës si data e prerjes për kualifikimin për kompensim, ndihmë dhe rivendosje për të gjithë personat që kanë ose nuk kanë të drejta ose pretendime ligjore mbi tokën që kanë zënë, por të cilët janë të pranishëm në zonën e prekur nga projekti në kohën e datës së prerjes. Inventarizimi i pasurive

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
	sipas ligjit. Janë të njohura vetëm të drejtat formale ligjore mbi tokën dhe strukturat, të regjistruara nga Sistemi i Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Përveç kësaj, individët të drejtat e të cilëve njihen sipas ligjeve kombëtare (pronësia faktike) mund të marrin kompensim nëse vërtetojnë statusin e tyre me dokumente të përshtatshme (kontratat shitblerjeje, dokumentacion trashëgimie etj.).		asurive dhe vlerësimi i pronave të prekura të tyre.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Kompensimi në vlerën e zëvendësimit	Kompensimi sipas ligjit për shpronësimin Nr. 8561 (shtesat 20/2016) për humbjen e pronave dhe asetëve përcaktohet në përputhje me çmimin mbizotërues të pronës/aktivitetit të prekur në tregu. Vlerësimi i pronave dhe pasurive merr parasysh natyrën e tyre, vlerën e tyre fillestare, zhvlerësimin, përdorimin e tyre të planifikuar, vendndodhjen e tyre dhe çmimet e tregut. Kriteret teknike për vlerësimin përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (neni 17). Llogaritja e kompensimit bazohet në çmimet mesatare të shitjes/blerjes të regjistruara në Sistemin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme gjatë 3 muajve të fundit. Nëse këto të dhëna nuk janë të disponueshme për tokën, çmimet merren nga të dhënat e Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave për një vendndodhje të caktuar, ose nga Ministria e Bujqësisë, e cila llogarit	Në lidhje me tokën dhe strukturat, "kostoja e zëvendësimit" përcaktohet si më poshtë: Për tokën bujqësore, është vlera e tregut e tokës me potencial ose përdorim të barabartë prodhues të pozicionuar në afërsi të tokës së prekur, plus koston e përgatitjes së tokës në nivele të ngjashme me ato të tokës së prekur para projektit ose para rivendosjes, cilado qoftë më e larta; Për tokën në zonat urbane, është vlera e tregut të tokës me madhësi dhe përdorim të barabartë, me objekte të ngjashme ose të përmirësuara të infrastrukturës publike dhe shërbimeve dhe e pozicionuar në afërsi të tokës së prekur përpara zhvendosjes; Për shtëpitë dhe strukturat e tjera, është kostoja e tregut e materialeve të nevojshme për të ndërtuar një strukturë zëvendësuese në një zonë dhe me cilësi të ngjashme ose më të mirë se ato të strukturës së prekur, ose për të riparuar	Kompensimi për humbjen e tokës paguhet sipas statistikave mesatare të krahasueshme të shitjeve për të arritur në zëvendësimin e përcaktuar në politikat e Bankës Botërore; nëse asnjë vlerë që vjen si rezultat i këtij procesi nuk e arrin vlerën e zëvendësimit, kompensimi do të rritet. Rritja do të vlerësohet nga ekspertë të akredituar, të cilët së pari do të përcaktojnë koston e zëvendësimit dhe më pas do të përcaktojnë shumën e nevojshme për të arritur në koston e zëvendësimit. Për përcaktimin e koston së zëvendësimit të tokës ose pronës të prekur, do të merret parasysh kostoja e vlerës së tregut plus taksat dhe tarifat, nëse ka. Në rastin e vlerësimit të koston së strukturave të

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
	vlerën bazuar në produktivitetin e tokës. Nëse të dhënat e tregut nuk janë të disponueshme për strukturat në fjalë, zbatohet metoda e vlerës ndërtimore, pra përcaktimi i kostove të materialeve dhe punës që nevojiten për të ndërtuar një strukturë të re zëvendësuese.	një strukturë pjesërisht të prekur, plus kostoja e transportit të materialeve të ndërtimit në truallin e ndërtimit, plus kostoja e çdo tarife punës dhe të kontraktorëve,	prekura, kostot e amortizimit të strukturave nuk do të merren parasysh dhe vlerësimi i kostove do të bëhet në bazë të se sa do të kushtojë për ndërtimin e një strukture të re me të njëjtën cilësi. Vlerësimi i strukturave të prekura do të marrë parasysh edhe kohën e investuar në ndërtim dhe taksat e aplikueshme, nëse ka. Arritja e kostos së plotë të zëvendësimit duhet të reflektohet në plan për të siguruar përputhshmëri me OP 4.12 dhe/ose me ESS5.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Llogaritë e rujatjes për pronarët që mundojnë/proceset e trashëgimisë/kompensimet e kontestuar	Ligji për shpronësimin Nr. 8561, datë 22.12.1999 (rishikuar në vitin 2016) parashikon se nëse pronari i regjistruar ka vdekur, ose mungon, dhe nuk është lëshuar certifikata e trashëgimisë, ministria përkatëse paraqet kërkesë në gjykatë për lëshimin e certifikatës. Nëse, gjatë procedurës së shpronësimit, pronari nuk gjendet, kompensimi depozitohet në një llogari në emrin e tij/saj. Nëse pronari është i panjohur, ministria përkatëse paraqet një kërkesë në gjykatë për transferimin e pronësisë në llogari të shtetit (neni 6). Çështjet që lidhen me të drejtat e pronësisë duhet të zgjidhen para se të bëhet pagesa e shpronësimit; në rast mosmarrëveshjesh, palët e prekura i drejtohen gjykatës për të vendosur se kush do ta marrë kompensimin, i cili është depozituar në një llogari të veçantë. Këto mosmarrëveshje nuk vonojnë procedurën e shpronësimit (neni 16).	<i>Në rastet kur huamarrësi ka ofruar të paguajë kompensim për një person të prekur në përputhje me planin e miratuar të rivendosjes, por oferta e tij është refuzuar, marrja e tokës dhe e pronave të lidhura mund të vazhdojnë vetëm nëse huamarrësi ka depozituar fonde të barabartë me shumën e ofruar plus 10 për qind në një formë të sigurt ruajtjeje ose depozitash të tjera me interes të pranueshëm për Bankën dhe ka ofruar një mjet të kënaqshëm për Bankën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në lidhje me ofertën e kompensimit në kohë dhe në mënyrë të barabartë (OP 4.12, shënimi 16).</i> <i>Nëse ekzistojnë vështirësi të konsiderueshme në lidhje me pagesën e kompensimit të personave të prekur, në mënyrë përjashtimore, me pëlqimin pShVRrak të Bankës, Huamarrësi mund të depozitojë fondet e</i>	Fondet e kompensimit të kërkuara nga si nga PVR-ja dhe nga ligji për kompensimin përfshirë ato të paparashikuara, mund të depozitohen në llogari me interes, nëse është e nevojshme, por vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe me miratimin pShVRrak të Bankës Botërore. Nëse aplikuesi për shpronësim nuk është në gjendje të depozitojë fonde në një llogari me interes, duhet të kërkohet një zgjidhje sistematike me qeverinë.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
		<i>kompensimit siç kërkohet nga plani (plus kostot e emergjencës) në një llogari ruajtjeje me interesi, ose në llogaria të tjera depozitash (ESS5 para 16).</i>	

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Mbështetje tranzitore	Asnjë kërkesë ligjore.	Instrumenti i rivendosjes duhet të përfshijë gjithashtu masa për të siguruar që personave të zhvendosur t'u ofrohet mbështetje pas zhvendosjes, për një periudhë tranzitore, bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të kohës që ka të ngjarë të jetë e nevojshme për të rikthyer jetesën e tyre të zakonshme dhe standardet e jetesës (OP 4.12 para 6 (c) (i)). Mbështetja tranzitore do të ofrohet sipas nevojës për të gjithë personat e zhvendosur ekonomikisht, bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të kohës së nevojshme për të rikthyer kapacitetin e tyre për të fituar të ardhura, nivele prodhimi dhe standardet e jetesës (ESS5 para 36).	Sigurimi që të gjitha kategoritë e personave të prekur kompensohen menjëherë në mjete monetare, ose në natyrë (përpara se të humbin aksesin në prona/aktive), në mënyrë që të minimizohet/shmanget humbja neto e të ardhurave dhe nevoja për mbështetje tranzitore. Specifikimi në matricën e kompensimeve të PMZ llojin e mbështetjes tranzitore që do të ofrohet dhe afatin kohor të ofrimit të saj për të përmbushir kërksat e Bankës Botërore.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Aspektet gjinore	Burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta në Shqipëri (Neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligji Nr. 9198 për Barazinë Gjinore në Shoqëri, i ndryshuar), duke përfshirë mundësinë për të pasur të drejta formale ligjore mbi pronat. Sipas Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë Nr. 9062, nëse gjatë martesës fitohen të drejta formale ligjore mbi pronën/pasurinë, ligji supozon se ato ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet bashkëshortëve, përveç nëse është regjistruar një marrëveshje tjetër formalisht në gjykatë (nenet 73 -76).	Vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave të grupeve të cënueshme midis personave të zhvendosur, veçanërisht grave (OP 4.12 para 8) .Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet aspekteve gjinore (ESS5 para 26, 33). Perspektivat e grave duhet të merren përmes konsultimit dhe interesat e tyre duhet të reflektohen në të gjitha aspektet (ESS5 para 18). Dokumentimi i pronësisë, banimit dhe kompensimit duhet të lëshohet në emrat e të dy bashkëshortëve, ose kryefamiljarit të vetëm, dhe llojet e tjera të ndihmës për rivendosje duhet t'u vihen në mënyrë të barabartë në dispozicion grave dhe duhet t'u përshtaten nevojave të tyre (ESS5 shënimi 175).	Në praktikë, sidomos në disa zona rurale, gratë nuk mund të marrin pjesë në aktivitetet e konsultimit në grup në numër të barabartë me burrat dhe mund të duhet të konsultohen përmes aktiviteteve specifike të konsultimit të synuara vetëm për to.

ÇËSHTJA	KËRKESAT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	KËRKESAT E OP 4.12 TË BANKËS BOTËRORE	MANGËSITË DHE MASAT PËR PËRMBUSHJEN E MANGËSIVE
Trajtimi i ankesave Për të shërbyer për çështjet e lidhura me shpronësimin dhe që dalin gjatë ndërtimit.	Përveç institucioneve të njohura zyrtarisht dhe mjeteve juridike për ankesa, nuk kërkohet asnjë procedurë tjetër për zgjidhjen e ankesave.	Duhet të përcaktohen procedura të përshtatshme, të përballueshme dhe të aksesueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të palëve të treta që lindin nga rivendosja; mekanizmat e tillë të zgjidhjes së ankesave duhet të marrin parasysh mundësinë e ofrimit të mjeteve gjyqësore dhe mekanizmat e komunitetit dhe tradicionale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.	Krijimi i një mekanizmi specifik dhe përpjestimor në projektet për trajtimin e ankesave.
Monitorimi dhe vlerësimi	Nuk kërkohen procedura të veçanta monitorimi	Huamarrësi është përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e përshtatshëm të aktiviteteve të parashikuara në instrumentet e rivendosjes.	Huamarrësi është përgjegjës për monitorimin në përputhje me kërkesat e parashikuara në KPZ dhe në çdo PVR përkatëse.

3. STRATEGJITË E KOMPENSIMIT PËR ZHVENDOSJE TË ZBATUESHME PËR PROJEKTIN TTF

3.1 PARIMET KRYESORE

KPZ-ja angazhohet për parimet kryesore, të cilat përfshihen në këtë PMSZ. Parimet për ndikimet e identifikuar mund të përmbliidhen shkurtimisht si më poshtë:

- Rivendosja dhe kompensimi i personave të prekur nga projekti do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me Politikën dhe Procedurat e Bankës Botërore për Rivendosjen e Pavullnetshme OP 4.12, ku do të prevalojnë ato kërkesa që janë më të forta.
- Individët e prekur do të kompensohen për humbjet përkatëse me koston e zëvendësimit për të lejuar kthimin në nivelin përpara zhvendosjes.
- Zbatimi i PMSZ-it dhe i rezultateve do të monitorohen dhe vlerësohen nga Njësia e Zbatimit të Projektit.

3.2 DATA KUFË E REFERENCES

Data e fillimit të censurit shërben si data kufi e references kohore. Personat që okupojnë toke pas kësaj date reference nuk gëzojnë të drejtën e kompensimit, ose ndonjë formë tjetër asistence për zhvendosje. Në të njëjtën mënyrë, asetet fikse (të tilla si strukturat e ndërtuara, të mbjellat, drurë frutorë dhe parcela me pylli) të ndërtuara pas datës së references nuk do të kompensohen.

Njoftimi i moratoriumit, i cili informon publikun e gjerë për këtë deklaram, do të shërbejë si data kufi e references për njohjen e të drejtave për kompensim.

Përveç kësaj, në fillim të censurit, çdo individ i anketuar informohet për datën e moratoriumit dhe për pasojat përkatëse për fillimin e ndonjë aktiviteti pas datës së censurit.

3.3 KRITERET E TË DREJTËS PËR KOMPENSIM DHE MATRICIA E PRONESIVE

Njësia e pronësive është çdo individ që ka të drejtën për të marrë kompensim ose përfitime rehabilitimi. Përcaktimi i njësisë së pronësive bëhet në vend duke hartuar dhe identifikuar me anë të regjistrimit një inventar të të gjitha aktiveve që preken nga Projekti dhe për të lejuar kompensim të plotë në përputhje me Matricën e të Drejtave të Pronësive. Të gjitha PAP-të identifikuar para Dates së references do të gëzojnë të drejtën e kompensimit, sipas parimeve të kompensimit të parashikuara në ligj, në këtë KPZ dhe në OP 4.12, ndërkohë që do të prevalojnë ato me të mirat për personat e prekur.

Personat e prekur nga projekti përfshijnë kategoritë e mëposhtme:

- Personat e prekur nga projekti, me titull formal pronësie, të cilët humbin të gjithë tokën e tyre, ose një pjesë të saj;
- Personat e prekur nga projekti, me titull formal pronësie, të cilët kanë pasuri të patundshme me ose pa leje ndërtimi në tokën objekt shpronësimi;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi bizneset që preken për shkak të shpronësimit të plote ose pjesor të tokës mbi të cilën ato ndodhen;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi blegtorinë dhe përpunuesit bujqësorë, të prekur nga humbja e plote ose pjesore të tokës mbi të cilën ato ndodhen;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal të qiramarrjes mbi tokën private ose publike;
- Personat e prekur nga projekti me titull formal mbi tokën që do të shpronësohet përkohejshëm gjatë periudhës së punimeve të ndërtimit;
- Personat e prekur nga projekti pa titull formal mbi tokën apo bizneset e prekura, jetesa e të cilëve varet drejtpërdrejtë nga toka apo bizneset e prekura (p.sh. personat që punojnë në tokën bujqësore që do të preket ose që punojnë në bizneset që afektohen nga projekti);
- Personat e prekur nga projekti pa titulli zyrtar pronësie ose përdorimi, por që konfirmojnë përdorimin e një tokë publike ose private për shkak të investimit në objekte të patundshme, në të mbjella, në pemë e dru frutore, në vreshta, dhe për shkak të moshës së kulturave bujqësore dhe kohës së nevojshme që ato kërkojnë për riprodhimin; dhe
- Cdo objekt komunal që preket nga projekti do të rikonstruktohet, ose komuniteti do t'i jepet mbështetja e nevojshme për të kompensuar humbjen e aksesit në objekte të tilla të përbashkëta me karakter komunal.

3.4 MATRICIA E TË DREJTAVE

Kategoritë e ndryshme të personave të prekur do të jenë sipas Matricës së mëposhtme të adoptuar nga ky KPZ

Tabela 1: Matrica e të drejtave

Kategoritë e prekura	Personat që gëzojnë të drejtën	Të drejtat
Humbja e të gjithë tokës	Pronarë në titull formal pronësie, pronarë me të drejtë të pranuarë për tokë që ata okupojnë para datës së referencës	Kompensim financiar bazuar në koston e zëvendësimit, duke përfshirë taksat.
Parcela toke/struktura	Pronarë me titull formal pronësie, pronarë me të drejtë të pranuarë	Nëse një parcelë e mbetur toke pas shpronësimit nuk është

të përdorshme ekonomikisht	per token qe ata okupojne para dates se references	ekonomikisht e perdorshme, edhe ajo do të kompensohet.
Strukturat dhe instalimet në tokë (plevica, kasolle, gardhe, etj.)	Te gjithë personat e prekur pavarësisht nga statusi ligjor i pronësise mbi keto asete	Kostoja e zëvendësimit për çdo investim të bërë, dhe vlera e kohës së investuar në ndërtim, pa amortizim. Materialet e riperdorshme do të jepen personave të prekur.
Shtëpitë e banimit	Te gjithë personat e prekur pavarësisht nga statusi ligjor i pronësise mbi aset	Prishja pjesore pa zhvendosje fizike: kompesim në cash me koston e zëvendësimit. Materialet e mbetura të riperdorshme do të jepen personave të afektuar. Nëse është i nevojshëm zhvendosja fizike (që ka pak të ngjare): kompesim në cash i jaftueshëm për të ndërtuar një strukturë banimi të krahasueshme, plus koston e transferimit dhe zhvendosjes, koston administrative, dhe pagesën për transportin
Kulturat bujqësore (përfshi fidanishtet)	Te gjithë personat e prekur pavarësisht nga statusi ligjor i pronësise	Kompensim për kulturat e humbura bujqësore apo bimët në fidanishte me vlerën e zëvendësimit
Bimët që prodhojnë fruta, vreshtat dhe drurët frutorë (pavarësisht nga mosha)	Te gjithë personat e prekur pavarësisht nga statusi ligjor i pronësise	Kompensim ekuivalent me koston për mbjelljen dhe rritjen e një vreshte apo pemtoreje zëvendësuesë, përfshi vlerën e kohës që nevojitet për riprodhim e zëvendësuesit, dhe kompensimin për prodhimin e humbur për vitet që nevojiten që vreshta apo pemtorja të arrijë prodhimtarinë e plotë
Zenjë e perkohshme e tokës	Pronarë me titull formal pronësie, pronarë që njihet e drejta e pronësise mbi token që ata kanë okupuar përpara datës së	Kompensim me cmimin e tregut të marrjes së tokës me qera për kohën e përdorimit. Toka duhet t'i kthehet personit të afektuar në të

	references	njejtat kushte ne te cilen eshte marre, dhe cdo permiresim qe i eshte bere duhet te mbetet po aty
Qiramarrësit e pronave publike, ose shtetërore	Pronare te pronave shtetërore	Ofrimi dhe përdorimi i pronave të tjera te ngjashme publike ose shtetërore me të drejtat e qiramarrësit për një periudhë ekuivalente kohe.
Humbja e punes ose te ardhura jo nga bujqesia	Te gjithë personat e prekur	Humbja e perkohshme e te ardhurave o te kompensohet me nje pagese te vetme ne cash e barabarte me te ardhurat neto per 6 muaj, bazuar ne raportin e zyres se taksave. Ne rast se ky raport nuk eshte disponibel, do te behet kompensimi per pagen minimale per 6 muaj. N erast te humbjes se perheershme te te ardhurave, do te jepet nje pagese tranzicioni, per nje kohe te arsyetuar e te justifikuar e cila nevojitet per te siguruar mjetet e meparshme te jeteses, plus trajnim per pune alternative nese eshte e mundur, plus prioritet per punesim ne projekt , nese eshte emundur dhe rast pas rasti (n eperputhje me vleresimet sociale te PMSZ
Përdoruesit e paligjshëm të tokës ose prone publike dhe private	Perdorues ilegale apo te pa legalizuar	Kompensimi me vleren e tregut per cdo permiresim+pune dhe kohe per te realizuar keto permiresime sipas cmimeve te tregut+ kostot e zhvendosjes se pajisjeve dhe instalimeve, nee ka+nje pagese tranzicioni dhe toke m eqera, nese eshte e mundur, ose prone te ngjashme nga inventari i shtetit
Grupet e cënueshme (familjet e prekura me	Grupet e cënueshme	Për këtë grup, atyre do t'u jepet ndihmë financiare shtesë për t'u siguruar që nuk do të jetojnë më keq pas projektit dhe që të mund të

shumë persona ne varesi, familjet me kryefamiljarë të papunë, familjet me persona me aftësi të kufizuara, familjet e varfëra)		mbajnë dhe t'u rikthehen mjetet e tyre të jetesës.
---	--	--

4. PERGATITJA E INSTRUMENTEVE INDIVIDUALE PER ZHVENDOSJEN

4.1 SKANIMI PER ASPEKTET SOCIALE DE HARTIMI I PMZ

Pergatitja e instrumenteve individuale te zhvendosjes alizohet pad perfundimit te skanimit per te percaktuar nese nje aktivitet i projektit mund te shkaktoje potencialisht ndikime te dukshme te padeshirueshme nga ana social, dhe qe me pas do te kerkoje perdorimin e instrumentave te duhur mbrojtës dhe masat lehtësuese per t'i administruar keto ndikime.

Skanimi social zakonisht konsiston ne kontrollin dhe identifikimin e ndikimeve/rreziqeve/mundesive sociale, si dhe identifikimin e masave per te zbutur keto ndikime te padeshirueshme, nese ka dhe qe lidhen me nje aktivitet te Projektit. (Formulari i Skanimit eshte bashkengjitur ne Aneksin 2).

Gjate procesit te pergatitjes se nje operacioni apo projekti financimi, skanimi do te realizohet per te kategorizuar ndikimet sociale dhe per te planifikuar masat e duhura zbutese. Procesi i skanimint dhe gjetjet e tij si dhe masat e propozuara zbutese do te dokumentohen si pjese e paketes se projektit apo aktivitetve te tij. Ne perzgjedhjen, dizenjimin dhe zbatimin e cilitdo operacion te financuar nga aktivitetet e Projektit do te ndiqen udhezimet, kodet e praktikave dhe kerkesat e pershkuara. Skanimi i aktiviteteve do te realizohet nga eksperti socio-mjedisor i punesuar ne NJZP. Raportet e skanimit do te aprovohen nga drejtuesi i NJZP dhe do te dorezohen n Banke. Skanimi do te bazohet ne kriteret e meposhtme dhe do te synoje te identifikojë besnikerisht nese aktiviteti i Projektit do te kete ndikime te padeshiruarane/per:

- (i) Strehim
- (ii) Asetet apo aksesin ne to
- (iii) Jumbje e burimit te te ardhurave apo mjeetve te jeteses, pavaresisht nga fakti nese personat e prekur do te zhvendosen ose jo ne nje vend tjeter

- (iv) Token
- (v) Bizneset
- (vi) Aksesin ne institucionet arsimore ose shendetesore
- (vii) Gruper e ceneshme dhe familjaret
- (viii) Shendetin dhe sigurine e komunitetit

Skanimi do te identifikojë Personat me te drejta formale pronesie mbi token dhe asetet (perfshi te drejatat zakonore ose tradicionale qe njihen nga ligji i vendt). Skanimi do te identifikojë gjithashtu Personat qe nuk kane te drejta formale pronesie mbi token, por qe kane nje pretendim per te drejten e pronesise mbi token dhe asetet perpara dates kufi te references. Skanimi nuk do te bazohet ne analiza apo te dhena te meparshme edhe nese jane ne te gatshme, por do te kerkoje nje vezhgmim ne ved per te konfirmuar i nformacionin e te dhenave te meparshme dhe qe ato jane te verteta, te besueshme dhe sakta per sa i perket mjedisit social. Ne rastet kur pas vezhgimeve ne vend akoma nuk kemi rezultate konkluzive duhet te behen perpjekje te tjera me intervista informuese, diskutime me grupet e interesit dhe metoda te tjera te provuara. Nese skanimi ka zbuluar se ka Persona sipas pershkrimeve te pmesiperme ne zonat e ndikuara prej Projektit, atehere do te pergatitet nje PMZ ose PMSZ, sipas rastit, bazuar ne kete KPZ.

Bazuar ë këtë KPZ, duke marrë parasysh shtrirjen e ndikimit pr sa i perket marrjes se tokes tokës dhe zhvendosjes, do të përgatiten Plane Masash specifike per Zhvendosjen (PMZ) ose Plane Masash të Shkurtuara per Zhvendosjen (PMSZ). Plani i Masave i Shkurtuar i Zhvendosjes mund të perdoret për të zbutur efektet e dëmshme, për të kompensuar humbjet dhe për të siguruar përfitime zhvillimi për personat dhe komunitetet e prekura nga një projekt investimi në rastet kur nga ky projekt preken më pak se 200 persona dhe kur ndikimet e zhvendosjes janë të vogla.

Objektivi i PMSZ është përcaktimi i procedurave që duhet të ndiqen dhe i masave që duhet të ndërmeren për shpronësime te tokes dhe për të kompensuar personat e prekur ne perptuthje me kete KPZ. Cdo PMZ per nje zone te caktuar do te bazohet ne informacione te besueshme dhe te fresketa per (a) ndikimet e pritshme dhe (b) çështjet ligjore të lidhura me zhvendosjen. Në lidhje me kompleksitetin e rrethanave të projektit, PMZ specifike duhet të përfshijë të paktën zërat e mëposhtëm:

- Përshkrimin e aktiviteteve te projektit qe rezultojne ne zhvendosje fizike apo ndikime ekonomike
- Identifikimin e zones se projektit dhe aktiviteteve te tij që çojnë në rivendosje;
- Alternativat e marra ne konsiderate per menjanuar apo minimizuar zhvendosjet
- Vleresimin e indikatorëve baze socio-ekonomike perfshi cnesusin, karakteristikat demografike te personave te prekur

- Shkallen dhe llojin e ndikimeve te pritshme
- Titujt e Pronesise
- Kuadrin ligjor dhe institucional
- Procedurat e zbatimit perfshi dhe mekanizmat e monitorimit
- Mekanizmin e Zgjidhjes se Ankesave
- Konsultimet me personat e prekur gjate pergatitjes dhe zbatimit te PMZ ose PMSZ
- Kostot dhe buxhetin.

4.2. MIRATIMI I PMZ

Aktivitetet në përgatitjen e PMZ për zona ose vende specifike do të bëhen publike në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e konsiderueshme e PAP-ve. Kjo nënkupton fazën e përgatitjeve, publikimin e ketyre përgatitjeve për regjistrimin e popullsisë, përbërjen e rezultateve të regjistrimit, duke respektuar privatësinë e informacionit personal, publikimin e vlerësimit të indikatorëve baze social-ekonomike, si dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për draftet e PMZ. Qëllimi i bërjes publike dhe diskutimit të informacionit me publikun është sigurimi i pjesëmarrjes kuptimplotë të PAP-ve në procesin e përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të instrumenteve të zhvendosjes.


Drafti i parë i PMZ duhet t'i dorëzohet Bankës Botërore për shqyrtim dhe miratim. Pasi të jetë miratuar, ai do të prezantohet (në gjuhën angleze në gjuhën shqipe) nga promovuesi i projektit në gazetën lokale në komunitetin e prekur nga projekti dhe në portalin e internetit të promovuesit të projektit, dhe do të pasohet nga konsultime publike me komunitetet lokale dhe palët e interesuara. Promovuesi i projektit do të përgatisë gjithashtu një informacion të përmblodhur të PMZ për t'ia prezantuar publikut, për t'u siguruar që personat e prekur i kuptojnë procedurat e kompensimit dhe dinë se çfarë të presin në fazën e ndryshme të projektit (për shembull, kur do t'u bëhet një ofertë, sa kohë do të kenë për t'u përgjigjur, cilat janë procedurat e ankimit, procedurat ligjore që duhen ndjekur nëse dështojnë negociatat, etj.). Rezultati i konsultimeve publike do të dokumentohet dhe do të raportohet në dokumentin përfundimtar të PMZ dhe i dërgohet BB-së për "Pranim". Pas pranimit, PMZ përfundimtar do të botohet përsëri në gazetën lokale në komunitetin e prekur nga projekti dhe në portalin e internetit të Promovuesit të Projektit, si edhe do të vihet në dispozicion gjatë gjithë projektit, zbatimit të PMZ dhe procesit të zhvendosjes.

4.3 ZBATIMI I PMZ

Asnjë aktivitet ndërtimi nuk mund të fillojë në qoftë se nuk është bërë kompensimi dhe derisa të jetë paguar kompensimi, ose deri sa të jetë shuma e duhur e kompensimit të jetë depozituar në një llogari ruajtjeje, ose llogari të ngjashme, ose deri sa të jetë bërë zëvendësimi i pronës së administruar nga PAP-ët, ose të jetë nisur një proces gjyqësor për të përcaktuar kompensimin në rast se nuk arrihet një zgjidhje e pranueshme nga palët.

Zbatimi i PMZ është detyrim për huamarrësin, detyrim i cili realizohet përmes Promovuesit të Projektit. Promovuesi i Projektit do të monitorojë zbatimin e përgjithshëm, do të bashkëpunojë me bashkitë në territorin e të cilave do të bëhen ndërtimet, të bashkëpunojnë me kontraktoret e punimeve dhe t'i japin informacion PAP-eve dhe komuniteteve.

Figura 1: Hapat ne pergatitjen e PMZ



5. KONSULTIMET DHE PUBLIKIMET

5.1. KONSULTIMET ME PUBLIKUN

NJZP do të krijojë një marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetet e prekura sa më herët që të jetë e mundur përgjatë procesit të planifikimit të projektit dhe gjatë gjithë jetës së projektit. Procesi i angazhimit do të sigurojë konsultime kuptimplota me ta për të lehtësuar një kuptim të ndërsjellë të natyrës dhe kohëzgjatjes së ndikimeve sociale, pjesëmarrjen e informuar mbi çështjet që i prekin drejtpërdrejt komunitetet, masat e propozuara zbutëse, shpërndarjen e përfitimeve dhe mundësive të zhvillimit, dhe aspektet e zbatimit. Me PAP mund të organizohen edhe takime individuale nese duhet, dhe me kerkese te PAP.

Ky KPZ dhe cdo PMSZ e mepasshme duhet te behet publike dhe të vihen në dispozicion për t'u analizuar nga publiku jo më vonë se 14 ditë para konsultimeve publike dhe duhet të lihet kohë e mjaftueshme për depozitimin e vërejtjeve pas konsultimeve publike. Të gjitha konsultimet publike do të shpallen në gazetave lokale dhe në portalin e internetit të NJZP. Informacioni për Projektin dhe për Mekanizmin e Zgjidhjes së Ankesave duhet të publikohen në anglisht dhe shqip.

5.2. PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE

Të gjithë dokumentet do të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Dokumentet duhet t'i vihen në dispozicion publikut gjatë të gjithë kohëzgjatjes së projektit, duke përfshirë edhe vlerësimin e projektit. Veresionet e dokumenteve në gjuhën shqipe (dhe/ose gjuhe te tjra shtese qe perdor komuniteti lokal) do të hidhen në faqen e internetit të NJZP dhe të autoriteteve vendore përkatëse. Të gjitha dokumentet do t'i paraqiten personave të prekur nga projekti në procesin e shpronësimit, veçanërisht grupeve të cënueshme. Atyre duhet t'u shpjegohet ndikimi i projektit mbi pronat e tyre dhe të drejtat që ata gëzojnë. Në bashkitë e prekura nga projekti do të lihen në dispozicion edhe versione të shtypura të dokumentacionit përkatës. NJZP është përgjegjës për të gjithë procesin e ofrimit të informacionit.

6. MEKANIZMI PËR ZGJIDHJEN E ANKESAVE

6.1 MEKANIZMI I ANKIMIMIT TE PROJEKTIT

Projekti do të ketë një Mekanizëm të vetin për Zgjidhjen e Ankesave dhe që do të përdoret për të gjitha aktivitetet e tij. Zyra për Trajtimin e Ankesave (ZTA) do të jetë pranë NJZP si entiteti përgjegjës për zbatimin e projektit. Kjo zyre do të shërbejë si qendër informimi në nivelin e projektit dhe si mekanizëm për zgjidhjen e ankesave, në dispozicion të personave të prekur nga zbatimi i të gjithë nënkomponentëve të projektit përgjatë të gjithë ciklit të projektit. ZTA do të jetë përgjegjëse për trajtimin e ankesave të marra nga Personat e prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga marrja e tokës dhe rivendosja, Banorët që jetojnë në bashkitë e prekura, dhe personat që besojnë se janë të prekur, direkt ose indirekt nga Projekti.

ZTA do të krijohet përpara fillimit të aktiviteteve të projektit. NJZP do të jetë përgjegjëse që publikimi i informacionit për ZTA të jetë transparent duke komunikuar rolin dhe ekzistencën e ZTA, funksionet e saj dhe personin e kontaktit, si dhe procedurat e dorëzimit të ankesave në zonat e prekura nga projekti. NJZP do të informojë komunitetet gjatë përgatitjes së investimeve specifike për rolin dhe ekzistencën e ZTA, funksionet e saj dhe personin e kontaktit si dhe procedurën e dorëzimit të ankesave përmes:

- Shpërndarjes së broshurave në komunitetet e prekura dhe
- Njoftimeve në vende të dukshme apo në vendet më të frekuentuara në zonat e projektit, si dhe në website të bashkive perkatese, kur të dihet vendi i saktë i aktiviteteve të projektit.

Do të bëhen përpjekje për të informuar siç duhet grupet ose personat e cënueshëm, për t'u siguruar që ZTA është lehtësisht e aksesueshme prej tyre, nëse atyre u duhet të kontaktojnë me të.

ZTA do të projektohet për të qenë sa më e aksesueshme, pa kosto për ankesën, efektive, efikase dhe pa përjashtuar asnjë mjet tjetër efektiv administrativ ose ligjor i parashikuar në legjislacionin kombëtar.

Eksperti Mjedisor dhe Social i rekrutuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit do të verifikojë nëse është bërë shpërndarja e duhur e informacionit përmes pyetësorëve të thjeshtë. Qëllimi i anketës është që të vlerësojë efektivitetin e ndarjes së informacionit dhe propozimi i masave lehtësuese në rast se rezultatet nuk tregojnë transparencë dhe akses të plotë në ZTA.

Cdo ankesë duhet t'i silltet në vëmendje ZTA në mënyrë anonime, personalisht ose me telefon, ose me shkrim, duke e përdorur fletën e ankesës përmes telefonit, e-mail-it, postës së zakonshme, faksit, ose dorazi individualisht në adresën e NJZP, adresë e cila do të bëhet e ditur kur të krijohet njësia. Pikat e aksesit dhe detajet për pikat e hyrjes do të bëhen publike dhe do të jenë pjesë e procesit të rritjes së ndërgjegjësimit. Formulari për regjistrimin e ankesave jepet në Aneksin 1.

6.2 ADMINISTRIMI I ANKESAVE NGA PROJEKTI


Cdo ankesë do të ndjekë shtatë hapat e mëposhtme të detyrueshme: marrjen, vlerësimin dhe caktimin e personit që do të shqyrtojë, njoftimin/njohjen, hetimin, përgjigjen, ndjekjen dhe mbylljen.

Pas regjistrimit të një anese, ZTA do të kryejë një vlerësim të shpejtë për të verifikuar natyrën e ankesave dhe për të përcaktuar sa të rënda janë ato. Brenda 3 ditëve nga depozitimi i ankesës, ajo lëshon vërtetimin e regjistrimit të ankesës dhe i jep parashtruesit të ankesës informacionin bazë për hapin tjetër. Më pas ajo fillon hetimin e ankesës duke u përpjekur ta kuptojë çështjen nga perspektiva e ankuesit dhe të kuptojë se çfarë veprimi kërkohet prej tij/saj. ZTA bën hetimin e ankesës duke shqyrtuar faktet dhe rrethanat, duke

intervistuar të gjitha palët e përfshira dhe duke biseduar me palët e interesuara. Pas hetimit dhe në varësi të ashpërsisë dhe llojit të ankesës, vendimi i përkohshëm do të diskutohet me ankuesin brenda 10 ditësh pas marrjes së ankesës. Njoftimi i njëanshëm do të përbëjë rast përjashtimor. Marrëveshja përfundimtare duhet të jetë specifike dhe duhet të lëshohet, ndërkohë që ankimuesi duhet të njoftohet për vendimin përfundimtar jo më vonë se 20 ditë pas depozitimit të ankesës. Mbyllja e ankimit bëhet pas verifikimit të zbatimit të vendimit. Edhe në rastet kur nuk arrihet një marrëveshje, ose kur ankesa refuzohet, është e rëndësishme të dokumentohet rezultati, veprimet dhe përpjekjet e përcaktuara në vendim dhe të mbyllet.

Në rast të ankesave anonime, pas lëshimit të vërtetimit për pranimin e ankesës brenda tri ditëve nga depozitimi, zyra vijon me hetimin e ankesës dhe nxjerr vendim përfundimtar brenda 20 ditësh nga depozitimi i saj. Vendimi botohet në faqen e internetit të promovuesit të projektit. Mbyllja e ankesës bëhet pas verifikimit të zbatimit të vendimit.

Figura 2: Hapat e ankimimit



ZTA mban një regjistër të ankesave, i cili do të ketë të gjithë elementet e nevojshme për të bërë ndarjet e ankesave sipas gjinisë së personit regjistruar dhe sipas llojit të ankesës. Çdo ankesë do të regjistrohet në regjistër shoqëruar e informacionin minimal të përmendur më poshtë:

- Përshkrimin e ankesës;
- Datën e vërtetimit të pranimit për ankimuesin;
- Përshkrimin e masave të marra (masat hetuese, korrigjuese), dhe
- Datën e vendimit dhe mbylljen/ofrimin e komenteve reflektuese për ankimuesin;

Roli i ZTA, përveç zgjidhjes së ankesave, do të mbajë dhe arshivojë komentet/ankesat e marra si dhe një regjistër qendror që do të administrohet nga Promovusi i Projektit. Në mënyrë që të behen të njohura këto instrumente dhe rezultatet e arritura, do të nihen raportime tre-mujore nga ZTA dhe që do të publikohen në website të Ministrisë. Këto raportime periodike do të zërthehen sipas gjinisë, tipi i ankesës/demit. Në mënyrë që dialogu të jetë i vazhdueshëm, do të embahen dhe takime tre mujore me publikun për të diskutuar rezultatet e zgjidhjes së ankesave në përgjithësi, të diskutohen raportet e ankesave dhe të informojë komunitetin për aktivitetet në vazhdim të Projektit.

7. MONITORIMI DHE VLERESIMI

7.1 MONITORIMI I PROCESIT TË ZHVENDOSJES

NJZP do të monitorojë zbatimin e procesit të zhvendosjeve edhe përmes procedurave të brendshme edhe në rrugë institucionale. Monitorimi dhe vleresimi nga një konsulent i jashtëm mund të realizohet gjatë përgatitjes së PMZ/PMSZ, nëse është e nevojshme, në konsultim me Bankën Botërore. Raporti përfundimtar i PMZ/PMSZ do të përgatitet e

dorezohet ne BB jo me shume se dy muaj pas perfundimit te tyre. Ai duhet te verifikojë qe te tera detyrimet dhe te drejtat jane plotesuar ne perputhje me PMZ/PMSZ per nje zone te caktuar. Pervec kesaj, raporti duhet te vleresojë nese masaat zbutese te pershkruara kane dhene rezultatet e pritshme. Statusi socio-ekonomik i popullsise se prekur duhet te matet perkundrejt indikatorë baze perpara zhvendosjes, sic jane hartur gjate censusit dhe studimeve fillestare socio-ekonomike.

Indikatorët e monitorimit te KPZ jane si ne vazhdim:

- Numri i diskutimeve me publikun per PMZ
- Numri i shpronësimeve te realizuara krahasuar me numurin total te pritshem
- Numri i PAP te kompensuar krahasuar me te pritshmin
- Vlera e kompensimit te paguar krahasuar me pritshmerine
- Numri dhe tipi i ndihmes qe u eshte dhene grupeve te cënueshme, dhe
- Numri dhe tipi i ankimeve, perfshi veprimet ligjore qe kane rezultuar nga shpronësimet (ankesat e depozituara, rastet e zgjidhura, koha qe eshte dashur per zgjidhjen e tyre)

8. KUADRI INSTITUCIONAL

8.1 INSTITUCIONET PERGJEGJESE PER ZBATIMIN E PROJEKTIT

Per kete Projekt, do te ngrihet nje NJZP ne Ministrine e Financave dhe Ekonomise, e cila do te kete pergjegjesine per zbatimin e projektit dhe te siguroje qe burimet e duhura financare jane alokuar per te, qe ato jane disbursuar, paguar, kontabilizuar dhe audituar. Ao do te jete nje entitet me funksion te dyfishte. Pervec aspekteve specifike qe lidhen me zbatimin e projektit ajo do te mbështetet nga mekanizma ekzistuese te koordinimit nder-ministror si Komiteti Kombetar per Lehtesimin e Tregetise (KKLT) i ngritur e perputhje me angazhimet rajonale (CEFTA) dhe multilaterale (OBT) per lehtesimin e tregetise. NJZP do te kete staf qe perfshin ekspertin socio-mjedisor i familjarizuar me politikat e BB dhe legjislacionin shqiptar, nje specialist prokurimesh, nje specialist finance, nje specialist per aspektet e lehtesimit te transportit dhe tregetise dhe nje drejtues te dedikuar si manaxher te NJZP. NJZP do te punoje ne bashkepunim te ngushte dhe e lidhur me ekiper tekniciene te Ministrive dhe agjencive te perfshira ne Projekt.

8.2 INSTITUCIONET KRYESORE NE PROCESIN E SHPRONESIMIT

Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, procesi i zhvendosjeve/shpronësimeve perfshin Keshillin e Ministrave, Ministrine e Infrastruktures dhe Energjië (si ministri e linjes) , komisionin ad-hoc te shpronësimit, Qeverine Vendore dhe Gjykatat perkatese ne rastet e mosmarrveshjeve.

Ministria e Infrastruktures dhe Energjië eshte pergjegjese per marrjen e propozimeve per shpronësim, dh epas marrjes se tyre dorezon kerkesen per deklarimin e shpronësimit per

interes publik ne Keshillin e Ministrave dhe ngre komisionin ad-hoc te shpronesimit qe perbehet nga zyrtare ose eksperte te pavarur, te paanshem dhe pa konflikte interesi.

Me poshte paraqitet nje panorame e institucioneve ne fjale. Pergjegjesite dhe kuadri institucional per zbatimin e KPS dhe PMZ/PMSZ specifike pershkruhet ne detaje ne vete keto dokumente.

Institucioni	Pergjegjesite Kryesore ne procPërgjegjësia
Keshilli i Ministrave	Deklarimi i interesit publik
Ministria e Infrastruktures dhe Energjise	Ngritja e komisionit ad-hoc te shpronesimeve, verifikimi i dokumentacionit per pronat, llogaritja dhe verifikimi i kompensimit. Pergatitja e vendimit per shpronesim
Ministrie a financave dhe Ekonomise	Perfaqesuesi i Huamarresit ne Marreveshjen e Kredise. Pergjegjese per ngritjen e NJZP (MOFE dhe NJZP jane ligjerisht nje entitet i vetem). Alokon buxhetin per kompensimet
NJZP	Pergjegjese per zbatimin e projektit, dhe e ngritur ne MOFE
Komisioni ad-hoc i shpronesimeve	I ngritur ne MIE per te realizuar shpronesimin dhe do te kontrolloje dhe realizoje proceduren e shpronesimit
Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Pluajtshme	Ne cdo qark te zones se Projektit, nen autoritetin e Zyres Qendrore te Rregjistrimit, pergjegjese per identifikimin dhe verifikimin e pronesive dhe kufive te tye
Gjykatat perkatese	Percaktojne kompensimin qe duhet te paguhet ne rast se nuk arrihet nje marreveshje mes paleve, si dhe merr vendimin per shpronesim per gjukaten administrative te shkalles se pare dhe pas kesaj, ne Gjukaten adminsitratve te Apelit. Vendimi per shpronesim hynne fyqi menjehere, qe do te thote qe apelimet e tij nuk kane per ta vonuar procesin dhe zbatimin

9. KERKESAT PER BUXHETIN DHE FINANCIMIN

Ne pergjithesi kostoja e kompensimit mbahet nga Qeveria e Shqiperise dhe buxheti i alokuar nga MOFE per nje vit te caktuar financiar. Kostot per zbatimin e KPZ perfshijne tre kategori: (administrative qe kane te bejne me kostot e shpronesimeve (sipas nevojave), (b) kompensimi per shrponeismin e tokes dhe aseteve te humbura perfshi pagesat e tranzicionit e te tjera, sipas nevojës.

Kostoja e përafërt për këtë projekt është 5,212,500 Lek, ose rreth 48,874.82 US\$, që përfshin të gjitha kategoritë e mesipërme.

Përgjegjësia për zbatimin e Projektit mbetet tek NJZP Zhvendosjet dhe Shpronësimet i takojnë administrativisht Ministrinë e Infrastruktura dhe Energji dhe Keshillit të Ministrave. Përgjegjësia financiare për shpronësimet, përfshi kompensimin që duhet të paguhet, etj. I mbetet Qeverisë së Shqipërisë, në përputhje me këtë KPZ, dhe që sigurohet nga Marrëveshja e Kredisë me IBRD (BB) dhe Qeverisë së Shqipërisë. Kjo KPZ dhe Marrëveshja mbizoterojnë ligjin e shpronësimeve dhe përcaktojnë masat që duhet të zbatohen nëse ka boshllëqe mes politikave të BB dhe ligjit të vendit.